100% SHIJE ME ËMBËLTUES NGA BIMA E STEVIAS 0% SHEQER 0% KALORI
ZGJIDH ANËN "GREEN" TË COLA



# FOTO/ Qarkullonte me armë dhe kokainë, pranga 39- vjeçarit në Tepelenë, mbante emblemë policie për t'iu shmangur kontrolleve

01 Maj, 2020 13:56 |



Madhësia e tekstit:

## TEPELENA

Një 39- vjeçar është arrestuar në Tepelenë pasi është kapur me armë zjarri dhe të ftohta si dhe kokainë.

Pagesa në Supermarket?

Saktësisht B.H, iu gjetën 1 armë zjarri, 1 armë sportive, 2 armë të ftohta dhe disa doza me kokainë.

Po ashtu i arrestuari përdorte një emblemë të Policisë së Shtetit për t'iu shmangur kontrolleve e cila iu gjet në makinë.

**NJOFTIMI NGA POLICA**

Krahës-Tepelenë

Qarkullonte me armë zjarri dhe armë të ftohta, posedonte lëndë narkotike kokainë, vihet në pranga 39-vjeçari.

Për t'iu shmangur kontrolleve, dyshohet se ky shtetas përdorte një emblemë të Policisë, e cila u gjet në makinë.

Kapja e 39-vjeçarit, nga shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, në bashkëpunim me FNSH Fier, në pikën e kontrollit në kufirin ndarës mes Tepelenës dhe Mallakastrës.

Në vijim të veprimeve u vu në pranga edhe pronari i automjetit ku u gjetën sendet e kundërligjshme.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri, 1 armë sportive, 2 armë të ftohta, doza me lëndë të dyshuar narkotike kokainë dhe një emblemë metalike si ato të Policisë së Shtetit.

Shërbimet e Policisë, krahas angazhimit 24 orë për monitorimin e zbatimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19, vijojnë punën për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë.

Në këtë kuadër, në pikën e kontrollit në rrugën nacionale Tepelenë-Mallakastër, në afërsi të Liqenit të Krahësit, për ndarjen e zonave të gjelbra, efektivët e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër dhe të FNSH Fier, gjatë kontrolleve të imtësishme për kapjen e personave të shpallur në kërkim dhe atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo me lëndë narkotike, evidentuan dhe arrestuan në flagrancë 39-vjeçarin B. H., banues në Tiranë.

Nga kontrolli personal iu gjetën në trup doza me lëndë narkotike kokainë dhe nga kontrolli i automjetit që drejtonte ky shtetas u gjetën 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë sportive, 1 thikë, 1 dorezë metalike dhe 1 emblemë e Policisë.

Në përfundim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në DVP Gjirokastër u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit B. H., 39 vjeç, banues në Tiranë.

Gjithashtu, po në vijim të veprimeve u bë edhe ndalimi i shtetasit R. Ç., 36 vjeç, banues në Tiranë, pronari i mjetit.

Materialet proceduriale në ngarkim të tij i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë ose sportive", "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës".

**(BalkanWeb)**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** arme arrestim embleme kokaine policia Tepelene

TË NGJASHME

Sekuestrohet kokainë dhe marijuanë në Greqi, godítet grupi që drejtohej nga çifti shqiptar, 5 të arrestuar
04 Maj, 2020

VIDEO/ Shkatërrohet banda e rrezikshme e drogës në Catania, 25 të arrestuar, mes tyre shqiptarë (EMRAT)
04 Maj, 2020

Shfaq Komentet (1)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

VIDEO/ Aksidenti në Vorë, shihni momentin kur makina 'fluturon' në ajër për disa metra policin. Kujdes, pamje të rënda!
04 Maj, 2020

Shpërthen bombola në Shkodër, plagoset 52-vjeçari. Niset me urgjencë drejt Tiranës
04 Maj, 2020

"Gomari hyri në vresht e më dëmtoi rrushin", si nisi sherri mes vëllezërve në Tiranë. Dhunohen me dru e leva, arrestohet njëri
04 Maj, 2020

Makina del nga rruga në Vorë, përplas 'BMW X5' dhe policin në krye të detyrës
04 Maj, 2020

"Shigjetat" kapin 17-vjeçarin që shpërndante drogë në Tiranë, arrestohet edhe lushnjari për tentativë vrasje
04 Maj, 2020

Ngacmoi vajzën në rrugë, përjashtohet nga Policia e Shtetit efektivi i Patrullës së Përgjithshme
04 Maj, 2020

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Aksidenti në Vorë, shihni momentin kur makina 'fluturon' në ajër për disa metra policin. Kujdes, pamje të rënda!
04 Maj, 2020

Së shpejti prindër për herë të parë, Klea dhe Elgiti zbulojnë me një video emocionuese gjininë e bebit
04 Maj, 2020

"Heronjtë e heshtur të Urgjencës", Rama publikon historinë e infermieres shqiptare në Bari, që punon vullnetarisht tek Trauma pas mbylljes së kufirit
04 Maj, 2020

VIDEO/ Shkatërrohet banda e rrezikshme e drogës në Catania, 25 të arrestuar, mes tyre shqiptarë (EMRAT)
04 Maj, 2020

"Më mirë djepi bosh sesa djalli brenda", Erl Murati: Politikanët në Shqipëri nuk duan drejtësi të pavarur, problemet e medias sonë të lidhura me realitetin shqiptar
04 Maj, 2020

(Video)BE ndihma për luftën kundër COVID-19, Soreca: Jemi pranë Shqipërisë, bashkë më të fortë
04 Maj, 2020

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Pse nuk janë bërë tampone masive për popullsinë? Zv.Ministrja e Shëndetësisë: Nuk është strategji e mirë. Kemi bërë testime imunologjike, në mes të javës do bëjmë publike përgjigjet
04 Maj, 2020

"Kurba pa logjikë", Lubonja: Duheshin identifikuar dhe asimptomatikët. Tek ne më shumë se bashkëpunim ka qenë dhunë, shtrëngim, frikësim
04 Maj, 2020

VIDEO/ Aksidenti në Vorë, shihni momentin kur makina 'fluturon' në ajër për disa metra policin. Kujdes, pamje të rënda!
04 Maj, 2020

A do kemi shtim të shifrave të COVID pas hapjes? Zv.ministrja e Shëndetësisë: Ja kur do shihet. Treguesit e vërtetë janë rastet në spital dhe ata në kujdes intensiv
04 Maj, 2020

E kaloi Shqipëria rrezikun nga COVID-19? Minxhozi: Kurba e shifrave do shihet 10 ditë pas 'ciklit të hapjes'
04 Maj, 2020

E izoluar në Itali, Artiola Toskën e merr malli për bashkëshortin: S'mundëm më, u bë kohë
04 Maj, 2020

SHKARKO & REGJISTROHU NË MY TELEKOM APP +3GB DHURATË

POROSIT PRODUKTET NGA SHTËPIA

EUROPE WEEK 2020 4-10 MAY STRONGER TOGETHER

DREJT KORÇA e në shtëpinë tuaj! POROSIT NE TELEFON! DERGESA FALAS! PAGUAJ KESH! +355 68 609 4104 ( WHATS APP & SMS )

DREJT fab e në shtëpinë tuaj! POROSIT NË TELEFON! DËRGESA FALAS! PAGUAJ KESH! +355 68 609 4104 ( WHATS APP & SMS ) 0,5L Sasia minimale 3 Koli ( 36 Copë )

HYSENBELLIU GROUP

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE
@balkanweb

BalkanWeb

EMISIONE NEWS24
Alert
Emisioni Chic
Emisioni Diplomaticus
Emisioni Vila 24
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Monitor Ekonomi
Real Story
Shqiptarët për shqiptarët
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI
Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA
New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

FAQET ZYRTARE
News24
Gazeta Shqiptare
Radio RASH

PRIVATËSIA
POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT
redaksia@balkanweb.com

© 2020 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.